

URDHËR
Nr. 207, datë 12.3.2025

PËR NGARKIM TË PËRKOHSHËM NË DETYRË (ZËVENDËSIM)

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Ngarkimin e përkohshëm në detyrë (zëvendësimin) e titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, z. Endrit Musaj, zëvendësdrejtorit të përgjithshëm të Arkivave, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni, me përjashtim të kompetencave të ngarkuara te drejtues të tjerë me urdhra të posaçëm përgjatë vitit 2025.
2. Ngarkimi i përkohshëm në detyrë (zëvendësimi) do të ushtrohet nga data 12.3.2025 deri në kthimin në detyrë të titullarit.
3. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet zëvendësdrejtori i përgjithshëm, z. Endrit Musaj.
Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardit Bido